# DËSHMI ARKIVI

**A-440096**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Varrezat e Sharrës mbulohen nga plehrat: “As kur vdes nuk pushon në paqe!” |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1391369.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 16:33:17 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 13 shtator 2026, 16:21:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 13 shtator 2026, 16:20:00 UTC → 13 shtator 2026, 16:22:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4813d10b1e579eac08be20152d4f2f63239528f5dfedca4590bfa1dd1c97266b` |
| TEKSTI | `97694e36f63c798ae455fc93a108c47346f70beda276d0919a3a92e4eac8349b` |
| PAMJA | `dfc80f5ce74fa3ad236b766036032cb250f03e38c3a441107e772b76f2d61004` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2ae89e39d80e80c39bc491a64633d599d096f4c758e4190158fd01bfc9c9b5d5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9a605a4f1977ffafcd955a727087f4d8630a9c3b096f49d9eff2d57be1cc228b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2ae89e39d80e80c39bc491a64633d599d096f4c758e4190158fd01bfc9c9b5d5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Varrezat e Sharrës mbulohen nga plehrat: "As kur vdes nuk pushon në paqe!"

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 13.09.2026, 18:21

Share Share



Një qytetar i është drejtuar JOQ Albania për të denoncuar gjendjen në varrezat e Sharrës, ku sipas tij situata është problematike jo vetëm për shkak të papastërtive, por edhe për mungesën e një planimetrie të qartë të varreve.

Sipas denoncuesit, familjarët që shkojnë për të vizituar të afërmit e tyre përballen me vështirësi për të gjetur dhe për të arritur te varret, deri në atë pikë sa, në mungesë të hapësirave dhe orientimit të duhur, rrezikojnë të shkelin mbi varret e tjera.

Por shqetësimi nuk ndalet këtu. Barishtet dhe mbeturinat duket se kanë pushtuar hapësirat e varrezave, ndërsa qytetari ngre pikëpyetje se kush duhet të kujdeset për pastrimin dhe mirëmbajtjen e këtij vendi.

"Përveç faktit që nuk ka një planimetri të saktë që të na lejojë të vizitojmë të dashurit tanë pa shkelur varret e të tjerëve, është skandaloze situata e papastërtive. Nuk vë askush dorë për të pastruar barishtet dhe plehrat", shprehet ai.

Një vend që duhet të jetë i mirëmbajtur dhe i denjë për njerëzit që prehen aty, duket se është lënë pas dore. Familjarët kërkojnë që të paktën në vendin ku shkojnë për të kujtuar të dashurit e tyre të mos përballen me papastërti, barishte dhe mungesë organizimi.

"Në Shqipëri, as kur vdes nuk pushon në paqe!", përfundon qytetari, duke kërkuar ndërhyrje dhe mirëmbajtje të varrezave të Sharrës.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.